



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



**Ref.:1016/26 Datë:29.06.2026**

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 151 të mbajtur më 16.06.2026, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet programi i studimit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2031):
  - *Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA) 240 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- II. Akreditohet programi i studimit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029);
  - *Gjuhësi Aplikative (MA) 60 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### ARSYETIM

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

| Nr. | Programi i studimit                              | Bartësit e programit                                                  |
|-----|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| 1.  | <i>Gjuhë dhe Letërsi Angleze ( BA) 240 ECTS;</i> | Sejdi Sejdiu<br>Jasmin Jusufi<br>Shkëlqim Millaku<br>Rezarta Ramadani |
| 2.  | <i>Gjuhësi Aplikative ( MA) 60 ECTS;</i>         | Dorine Rakaj                                                          |

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

**Për programin e studimit; Gjuhë dhe Letërsi Angleze ( BA) 240 ECTS** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.

**Për programin e studimit; Gjuhësi Aplikative ( MA) 60 ECTS** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.

Referuar në paragrafin 2 të nenit 35 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, “Kohëzgjatja e akreditimit të programit është tre (3) vjet”, andaj KShC bazuar në kompetencat

dhe diskrecionin në vendimmarrje ka vlerësuar se edhe pas përmbushjes së shumicës së fushave të standardeve Plotësisht apo Substancialisht, përtej rekomandimit të ekipit të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, vendosi që programi *Gjuhësi Aplikative (MA) 60 ECTS* të akreditohet për periudhën tre 3 vjeçare për shkak se programi është Akreditim për her të parë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 151-të, të mbajtur më datë 16.06.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

